

## AKT THEMELIMI

I shoqerise me perjegjesi te kufizuar "ALPI Albania Power & Infrastructure" sh.p.k

Sot me date **03/09/2024**, (dymje e njezete e kater) Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit Nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Regjistrimin e Biznesit" (i ndryshuar Ligjin nr.9916, datë 12.05.2008, Ligjin Nr.92/2012 dhe Ligjin Nr.8/2015), dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare, me vullnetin e tyre te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi ortaket:

**Ozgur EROL**, i datelindjes 02 Maj 1978, lindur ne Denizli, Turqi dhe banues ne Turqi, shtetas Turk, madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaport me nr. U26242345 dhe nr.personal turk **40744077036**.

**Baris EROL**, i datelindjes 31 KORRIK 1984, lindur ne Denizli, Turqi dhe banues ne Turqi, shtetas Turk, madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaport me nr. Personal turk **40705078348**.

**Serdar YUMUK**, i datelindjes 07 SHKURT 1986, lindur ne Denizli, Turqi dhe banues ne Turqi, shtetas Turk, madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaport me nr. U32236141dhe nr.personal turk **34459299814**.

**Mustafa ZEYBEK**, i datelindjes 15 MaRS 1976, lindur ne Denizli, Turqi dhe banues ne Turqi, shtetas Turk, madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaport me nr. U27545286 dhe nr.personal turk **33208313474**.

I cili me cilesine e "Ortakut Themelues" nenshruan kete akt themelimi, nepermjet te cilil deklaron se me vullnet te lire, te plete e te singerte, dhe inisiativen e tij te lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" ne ligjin "Per Regjistrimin e Biznesit" ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me perjegjesi te kufizuar, me emertimin "ALPI Albania Power & Infrastructure" shpk.

### KREU I

Emertimi , Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

### Neni I

Emertimi

Emertimi i shoqerise me perjegjesi te kufizuar eshte "ALPI Albania Power & Infrastructure" shpk.

## Neni 2

### *Forma Juridike*

Shoqeria "ALPI Albania Power & Infrastructure" shpk. eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me perjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria"), e themeluar nga personi fizik i siperpermendur, i cili perggjigjet per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbalon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkuara. Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria, pasi te kete fituar personalitetin juridik, eshte perjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj. Kapitali i Shoqerise "ALPI Albania Power & Infrastructure" shpk, ndahet ne kuota te ortakeve themelues dhe qe perballojne humbjen vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

## Neni 3


### Selia

Shoqeria e ka seline ne objektin me adresë : Rruga "Gentian" pallati Bruci 2007 kati i dyte, Lagjia 14, Tirane. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hap zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqipërisë, me vendim te ortakeve te shoqerise.

## Neni 4

### Objekti

- **Prodhim dhe shitja e produkteve ushqimore**, import-eksporti i i cdo lloj ushqimi, blerja dhe shitja i produkteve ushqimore me pakicë dhe shumicë, hapja e dyqaneve të shitjes, degëve dhe kioskave, marrja me qira dhe blerja e hapësirave për prodhim dhe shitje, nënshkrimi i kontratave me palët përkatëse si klient dhe furnitor per produkte si (arra, hallva, akullore, llokume turke, fruta te thata etj.)  
Të marri pjesë në kompani të tjera, bashkëpunimi me kompani të tjera, të krijojnë degë duke bërë marrëveshje ekskluziviteti, marrja e të drejtave të markës-patentave në lidhje me këto vepra, marrja në dorëzim nga të tretët dhe transferimi i tyre tek të tretët.
- **Aktivitete te ndryshme ne fushen e energjise elektrike** dhe energjise se rinnovueshme. Krijimin, ngritjen, funksionimin e objekteve linjave dhe plantacioneve të prodhimit të energjisë dhe shitjen e saj. Marrja dhe marrja me qira e objekteve operuese dhe/ose licencave, lejeve, autorizimeve dhe të drejta të ngjashme ne fushen e energjise, marrja në dorëzim e të drejtave të operimit, përvitja e shoqërive që zotërojnë këto të drejta,



pjesëmarrja në to, transferimi i objekteve të fituara ose kalimi i të drejtave palëve të treta, bashkëpunimi me palët e treta dhe partneritet biznesi midis tyre per te arritur qellimet e kompanise. Marrja e të drejtave (licencat, leje, autorizime dhe të ngjashme) në lidhje me burimet për prodhimin e energjisë (gaz i landfillit, qomyri, gazi natyror, gjeotermale, diellore, erës dhe cdo lloj menyre tjeter e prodhimit te energjise), aplikimi ndaj subjekteve të nevojshme publike dhe private në lidhje me këto të drejta, kryerja e negociatave, lidhja e kontratave, pjesemarrja ne tendera, ofertimi, pjesëmarrja në ankande, dhënia e kolateralit, tërheqja e kolateralit, shtim i vleres se kolateralit, nënshkrimi i Marreveshjeve Energjitike, hyrja në një angazhim (Aktmarrëveshje e Blerjes së Energjise). Të transferojë të drejtat në lidhje me këto burime te palët e treta, bashkëpunimi me palë të treta për këto qëllime, kontraktimi i punimeve të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë, bërja e ofertave të ndërtimit dhe instalimit të objekteve energjitike me çelës në dorë dhe/ose per zera te vecante te punës, lidhja e kontratave me nënkontraktorët për këto punime, bashkëpunimi me palë të treta dhe partneritet biznesi për këto qëllime, të marrë tokë, parcelë, arë, të drejtën e përdorimit të sipërm, të drejtë servituti për të operuar kur është e nevojshme për të gjitha këto punime dhe qellime, te bleje dhe te tjetersoje pronat, te marre lejen e ndërtimit, lejen e përdorimit të ndërtimit dhe te kryej veprime të ngjashme, te ofroje konsulence teknike për t'i pajisur të tretët me teknikë dhe informacion teknik në lidhje me këtë fushe. Te ofroje dhe sigurojë konsulencë administrative dhe ekonomike.

- **Import - eksporti** i të gjitha llojeve të produkteve tekstile, vegla, atrecatra dhe materiale ndërtimi (skela, kallëpe, etj.), kimikate ndërtimi, naftë dhe produkte të naftës, materiale elektrike dhe elektronike, makineri ndërtimi dhe pjesë këmbimi.
- **Te ushtroje aktivitet ne fushen minerale** të kryejë veprimtari kërkimore të të gjitha llojeve të minraleve, metaleve, gurëve të çmuar, burimeve gjeotermale, qomyrit, mermerit, gurit natyror, nxjerrjen e tyre, përpunimin, shitjen, ndërmjetësimin në shitjen e minraleve. Ndërtimi dhe vënia në funksionim e objekteve linjave te prodhimit dhe minierave të nevojshme për këto punime, transferimi i tyre tek të tretët, marrja e licencave, lejeve etj., perfitimi i të drejtave që lidhen me këto, aplikimi pranë subjekteve të nevojshme publike dhe private lidhur me këto të drejta, kryerja e negociatave, lidhja e kontratave, pjesemarrja ne tendera ose ankande, dhënia e ofertave, dhënia e garancive, tërheqja e garancive, dhënia e garancive shtesë, supermarrja etj.
- **Të zhvilloje aktivitet ne fushen e ndertimit**, te realizoje ndërtime të të gjitha llojeve të objekteve si ato civile ashtu dhe industriale, objekte shteterore ose private, objekte të infrastrukturës, të shesë, të blejë pasri te paluajteshme ne permbushje te kesaj fushe, të veprojë si ndërmjetës dhe ndërmjetës në blerje dhe shitje, kontraktimi ose vënia në punë, dhënia e ofertave të ndërtimit me çelësat në dorë dhe/ose një pjesë e veprës, pjesemarrja ne tendera, lidhja e kontratave, nenshkrimi i marrëveshjeve me nënkontraktorët për këto punime, bashkëpunimi me palë të treta për këto qëllime.  
Për të gjitha këto punime, kur është e nevojshme, blerja dhe shitja e pasurise se paluajtshme si truall, parcelë, arës, dhënia me qira, lidhja e kontratave ndërtimore në këmbim të banesave



(me klering), regjistrimi i pasurive te paluajtshme dhe tjetersimi i tyre, aplikimi per leje ndërtimi, leje për përdorimi dhe veprime të ngjashme, si dhe dhënia e lejes për palët e treta për këto punë duke ofruar konsulencë teknike dhe administrative. Ofrimi i shërbimeve të konsulencës ekonomike, teknike dhe administrative palëve të treta në lidhje me punimet e ndërtimit, ofrimi i shërbimeve të konsulencës financiare në lidhje me transaksione të tillë si investime direkte, transferim shoqërie, blerje, bashkim operatoresh dhe ndarje për këto qëllime.

### Neni 5

#### Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per një periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

### KREU II

#### KAPITALI

### Neni 6

#### Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 200,000 leke dhe eshte i perbere nga 4 kuota. Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht ne te holla nga ortaket i shoqerise perkatesisht:

Z. Ozgur EROL zoterues nje kuote, me vlore te pergjithshme 100,000 Leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.


Z. Baris EROL zoterues nje kuote, me vlore te pergjithshme 80,000 Leke, qe perben 40% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Z. Serdar YUMUK zoterues nje kuote, me vlore te pergjithshme 10,000 Leke, qe perben 5% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Z. Mustafa ZEYBEK zoterues nje kuote, me vlore te pergjithshme 10,000 Leke, qe perben 5% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlore te tregtueshme. Kontributi i ortakeve mund te jetë ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta)

### Neni 7



### Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoquerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegirnise;
- ç) dhurimit;
- d) cdo menyre tjeter e parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim. Ky rregull kushtezon kalimin e kuotave te treteve jashte shoquerise, me miratimin e shoquerise dhe te drejten e parablerjes ne favor te shoquerise apo te ortakeve te tjere, sipas modaliteteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit. Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pernjigjen ne menyre solidare ndaj shoquerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga casti i kalimit te kuotave, deri ne castin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit, sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

### KREU III

#### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

##### Neni 8

### Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoquerise. Asambleja e Ortakeve si organi i vetem vendimmarres i shoquerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB-se per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoquerise. Asambleja e Ortakeve vodos per ceshtje si:

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoquerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizua;
- ç) percaktimin e shperblimeve;



d) mbikeqyrjen e zbatimit te politik ave tregtare nga administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;

e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;

f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

Te gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakeve regjistrohen ne nje register te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;

b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;

c) investime;

ç) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pavec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

#### Neni 9

##### Marrja e vendimeve

Asambleja e Ortakeve per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise, vendos me vote. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB-se per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### Neni 10

##### Administrimi i Shoqerise

Shoqeria do te administrohet nga dy administratorme te drejte firme ku nenshkrimi i aktit vetem nga njeri prej tyre eshte i mjaftueshem per vlefshmerine e veprimeve juridike. Administrator te shoqerise jane:

**Z. Ozgur EROL**, i datelindjes 02 Maj 1978, lindur ne Denizli, Turqi dhe banues ne Turqi, shtetas Turk, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaport me nr. U26242345 dhe nr.personal turk 40744077036,

**Z. Baris EROL**, i datelindjes 31 Korrik 1984, lindur ne Denizli, Turqi dhe banues ne Turqi, shtetas Turk, madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaport me nr. Personal turk **40705078348**.

te cilet do te ushtroje funksionet ne kete detyre per nje periudhe 3 (tre) vjeare me te drejte riparteritje. Asambleja e per gjithshme mund te shkarkoje cilindo prej administratoreve ne cdo kohe me shumice te zakonshme.

Statuti, apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte. Pervec kesaj, administratori shkarkohet nga gjykata per shkelje te ligjit me kerkese te cdonjerit prej ortakeve. Tagrat e perfaqesimit te administratorit dhe cdo ndryshim i tyre njoftohen per regjistrim prane Qendres Kombetare te Biznesit. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

## Neni 11

### Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e per gjithshme;
- b) te perfaqesoje shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) te pergatisi dhe nenshruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se per gjithshme per miratim;
- d) te krijoje nje sistem parala jmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) te kryeje regjistimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- e) te raportoje perpara asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posayme me rendesi te veyante per vepri mtarine e shoqerise tregtare;

Administratori eshte i detyruar te therrasi asamblene e per gjithshme edhe ne rastet kur: Asambleja e per gjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas

regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlore me te larte se 5 % te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit finanziare te certifikuara.

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem.

Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjitha personave fizik e juridik, publik dhe/ose privat vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshire ketu autoritetet gjyqesore te te gjitha shkalleve.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.


Shoqeria nuk merr persiper pasojet ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

#### ASAMBLEJA E ORTAKEVE


Z. Ozgur EROL



Z. Serdar YUMUK



Z. Baris EROL



Z. Mustafa ZEYBEK

